

KODI I ETIKËS

(EMRI I KOMPANISË)

(EMRI I KOMPANISE SUAJ) Do të drejtojë aktivitetin e saj në mënyrë të ndershme dhe etike kudo që veprojmë në botë. Ne do të përmirësojmë në mënyrë konstante cilësinë e shërbimeve tona, produkteve dhe operacioneve dhe do të krijojmë reputacionin e ndershmërisë, besueshmërisë, respektit, përgjegjshmërisë, integritetit, dhe gjykimit të drejtë të sipërmarrjes. Asnjë sjellje joetike apo e paligjashme e nëpunësve, drejtorëve, punonjësve apo ortakëve tanë nuk është interes të kompanisë. (EMRI I KOMPANISE) nuk do të cenojë parimet e saj për përfitime afatshkurtra. Performance etike e kompanisë është shumatorja e etikës së burrave dhe grave që punojnë në këtë kompani.

Nëpunësit, drejtorët dhe punonjësit e kompanisë nuk duhet të lejojnë asnjëherë interesat e tyre personale për të gjeneruar konflikt, në dëm të interesave të kompanisë, klientit apo ortakëve. Nëpunësit, drejtorët dhe punonjësit duhet të jenë të kujdesshëm të përfaqësojnë (EMRI I KOMPANISE) në çdo transaksion me të tjerë me të cilët kanë marrëdhënie biznesi apo partneriteti. Nëpunësit, drejtorët dhe punonjësit duhet të mos përdorin kontaktet e kompanisë për të ngritur sipërmarrjet e tyre ose interesa personale me shpenzimet e kompanisë, të klientëve ose ortakëve të saj.

Asnjë ryshfet haraç apo pagesë e tillë nuk duhet dhënë tek asnjë person apo organizatë me qëllim tërheqjen apo influencimin e aktivitetit të biznesit. Nëpunësit, drejtorët dhe punonjësit duhet të mënjanojnë dhuratat, përfitimet, pagesat, bonuset, apo trajtimin e veçantë në qëllim influencimin e aktivitetit të biznesit.

Nëpunësit, drejtorët, dhe punonjësit e (EMRI I KOMPANISE) do të jenë në kontakt ose në posedim informacione sensitive të biznesit dhe duhet të marrin masat e duhura për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit. Ky informacion – i kujdo qofte, kompanisë apo klientëve apo ortakëve – mund të përfshijë plane biznesi strategjike, rezultate pune, strategji marketingu, lista klientësh, rekorde personale, investime të reja, blerje të reja, kosto manufakture, metoda dhe procese të ndryshme pune, etj.. pronësia dhe trajtimi i informacioneve sensitive të biznesit për këtë kompani apo kompani të tjera, individë dhe entitete duhet të trajtohet me kujdes dhe diskrecion të plotë dhe mund të shpërndahe vetëm në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Keqpërdorimi i materialeve brenda informacioneve që kanë të bëjnë me tregtinë dhe sigurinë e kompanisë mund të jenë objekt i sanksioneve civile ose penale për punonjësin që i ka keqpërdorur. Drejtorët, nëpunësit dhe punonjësit në posedim të materialit që nuk është publik konsiderohen “insiders”. Bashkëshortët, miqtë, brokerat dhe të tjerë persona nga jashtë kompanisë që mund të kenë marrë këtë informacion drejtëpërdrejtë ose indirekt nga punonjësit, nëpunësit apo drejtorët konsiderohen po ashtu “insiders”. Ky akt ndalon “insiders-at” të tregtojnë ose rekomandojnë shitjen ose nëse është me interes të influencojnë ty apo dikë tjetër në blerjen ose shitjen e informacioneve të sigurisë për çdo kompani me të cilin kemi marrëdhënie pune, të cilët kjo

nxjerrje informacioni mund ti cenojë. Udhëzimet e mëposhtme do të ndiqen për informacionin e brendshëm:

- Deri kur informacioni të publikohet punonjësi nuk ka të drejtë të shpërndajë informacionin përveçse rasteve kur pozicioni i punës e kërkon dicka të tillë.
- Punonjësit nuk duhe të blejnë ose të shesin informacionet e sigurisë të kompanisë kur ata kanë njohuri mbi një material deri sa ky informacion të jetë bërë i aksesueshëm për publikun dhe publiku kishte kohë të mjaftueshme për përvetësimin e informacionit.
- Punonjësit duhet të mos blejnë apo shesin informacionet e një korporate/kompanie tjetër, vlera e të cilave mund të cënojë aktivitetin e kompanisë për të cilën punonjësi ka njohuri dhe nuk është shpallur publikisht.

Nëpunësi, drejtori dhe punonjësit do të kërkojnë që informacioni të mbahet me kujdes dhe ndershmëri siç dhe kërkohet nga rregulloret e brendshme.

Nëpunësit, drejtorët dhe punonjësit do të përmbahen nga përdorimi i mjeteve të tjera të paligjshme dhe nga përdorimi i informacioneve të përfuara në mënyrë të paligjshme. Nëpunësit, drejtorët dhe punonjësit e (EMRI I KOMPANISE) do të anashkalojnë përdorimin e krahasimeve të ekzagjeruara apo të shërbimeve të tyre me ato të konkurrentëve.

Nëpunësit, drejtorët dhe punonjësit do të zbatojnë ligjet dhe aktet e Mundësive të Barabarta të Punësimit duke respektuar me përgjegjësi detyrat edhe para palëve të treta.

Nëpunësit, drejtorët dhe punonjësit do të jenë të balancuar në mënyrë që jeta e tyre personale të mos ndërhyjë me aftësiunë e tyre për të kryer shërbimet apo realizuar punimet për kompaninë dhe klientët e saj. Nëpunësit, drejtorët dhe punonjësit dakordësojnë të distancohen nga sjelljet joetike, të pandershme, të jashtëligjshme apo nga shkelja e politikave të kompanisë dhe procedurave të miratuara nga menaxherët e drejtëpërdrejtë.

Shkelja e këtij Kodi Etike është shkelje disiplinore dhe mund të çojë deri në ndërprejren e marrëdhënies së punës. Shkalla e masës disiplinore do të vlerësohet në bazë të faktit nëse ka qenë një përhapje apo shkelje etike vullnetare dhe nëse shkelësi ka bashkëpunuar apo jo me një hetim të mëvonshëm apo ndërlidhur.

Kujtohuni se sjellja etike do të thotë biznes/punë etike.